



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MIRDITË

Nr. 2843 prot

dt. 4. 9. 2020

V E N D I M

Nr. 13, datë 4. 9. 2020

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E RE PËR  
ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 469, datë 10.06.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar,

**V E N D O S A:**

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
  - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim;
  - b) Materiali hartografik:
    - i. Harta e Përdorimit të Tokës;
    - ii. Harta e Projektimit Urban;
    - iii. Harta e Infrastrukturës së Transportit;
    - iv. Skema e apartamenteve dhe banesave kolektive.
2. Miratohet rindërtimi në Zonën e Re për Zhvillim për Fazën I, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, me qëllim rindërtimin e objekteve të cilat referuar aktekspertizës së thelluar dhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.

Faza II e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim është orintuese për zhvillim e zonës, në rastet e paraqitjes së kërkesave për zhvillim e pronave nga sektori privat dhe pronaret.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, , në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Plani i Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, të integrohet me Planin e Përgjithshëm Vendor në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

**K R Y E T A R I**

**NDREC DEDAJ**

